



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 7, datë 20/05/2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË” , SUBJEKTIT
“KILIC AQUACULTURE ALBANIA” SH.A**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për akuakulturë, subjektit “Kilic Aquaculture Albania” sh.p.k, me vendndodhje Bashkia Vau-Dejës, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhjet e burimeve ujore (KRGJSH), Pompat e ish fabrikës së Pasurimit të Bakrit në Vaun e Dejës.

- X= 470462
- Y= 4652607
- Z= 44 m.m.n.d

Prurja e ujit që jepet për përdorim: 20 l/sek.

Pika e shkarkimit (KRGJSH).

- X= 470336
- Y= 4652650
- Z= 37 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

